



**BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK**

Proçes- verbal

I mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak Kurbin 30.06.2025.

Mbajtur me datë 30 qershor 2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

Të pranishëm 28 këshilltarë

Drejton Mbledhjen zj. Edlira Lleshi, Kryetare e Kwshillit Bashkiak

Kryetarja e Bashkisë, Zj. Majlinda Cara (e pranishme pas vendimit 4)

Nenkryetari I Bashkise z. Eduart Kurti

Drejtori I Ndhmës ekonomike, z. Llesh Ndoci

Drejtori I Pyjeve z. Artan Miza

Qytetare te ndryshem.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Kemi edhe barometrën e barazisë gjinore, për të cilën do të referojë Komisioni I barazisë gjinore. Kjo do bëhet thjesht si informacion, thjesht si informacion. Jeni dakord ta fusim në rend dite? Kush është dakord, kundër, abstenim? Tjetër kush është, Antoni.

Anton Kolziu, këshilltar: Përshëndetje të gjithëve, kam një kërkesë për kazanat e mbeturinave një, për sinjalistikën rrugore dy, dhe për punimet që po bëhen te pallatet te pazari, për problemet e një pallati që janë bërë punimet aty a janë bërë në bazë të projektit apo nuk janë bërë se më të... informacion ose që di unë nuk janë bërë.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Domethënë kërkon informacion për disa problematika. Kush është dakord? Kush është dakord atëherë miratohet. Tjetër, Laurini.

Lauren Sana, Këshilltar: Ë faleminderit, ë gjithashtu dhe unë kisha për pjesën koshave të mbeturinave, ë menaxhimi dhe zjarrvënja domethënë që po e shohim këto ditët e fundit si po menaxhohet. Ka ëh gjithashtu kisha dhe informacion për pjesën e bujqësisë, kanalizimet dhe gjithashtu dhe për pjesën e ujësjellësit ka si po vijon pjesa.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Tani ju kërkon informacion, normalisht do ta diskutojmë, do bëhet në protokoll dhe informacioni do vijë mbledhjen tjetër, po pra do mbahet në protokoll.

Albert Ndoci, këshilltar: Unë do të paraqes një kërkesë e kam dhe me shkrim për pagimin e qirasë të zyrës së Partisë Demokratike, dega Kurbin, pagimin e qirasë.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Nga kush kërkon me e pagu atë qira?

Albert Ndoci, këshilltar: Po bashkia

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Nga bashkia ke kërkesën muajin mars 2025.

Vendimi 1: Miratimi I ndihmës ekonomike 6% për muajin qershor 2025

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: para se ta her në votim, ka pyetje, diskutime në lidhje me ndihmën ekonomike. Për ndihmën, ju lutem. Ju lutem, Aida.

Aida Skeja, Këshilltare: E nderuar kryetare e këshillit, ju lutem, të nderuar pjesëmarrës, dy pyetje të thjeshta kam në lidhje me ndihmën ekonomike. E para, duke u referuar komunikimit që konsistent që ka ekzistuar gjatë gjithë kohës me zyrën e punës, pyetja parë lidhet sa persona që marrin ndihmë ekonomike janë të aftë për punë dhe sa prej tyre kanë bërë kërkesë për punësim, lidhur nga kërkesat për ndihmë ekonomike a ka patur rakordime me zyrën e punës me qëllim punësim? Të personave përfitues të ndihmës ekonomike, se në rast se ka persona të cilët e refuzojnë punësimin nga zyra e punës, pse t'ju jepet ndihma ekonomike? Faleminderit.

Pashke Marku, Përgjegjëse e ndihmës ekonomike: Atëherë me gjithë të gjithë individët që marrin ndihmë ekonomike shkojnë dhe firmosin kërkesën e punës, janë insistuar, në moment që zyra e punës u ofron punë dhe ato na refuzojne, dalin prej liste.

Aida Skeja, këshilltare: a ka një listë një ka një një sa persona kanë aplikuar për te zyra e punës nuk e kanë marrë. Sepse unë di që te zyra e punës ka mjaftueshëm pozicione pune profesionale dhe lidhur me këtë në rast se ka pse pse jo t'ju jepet ndihma ekonomike atyre personave të cilët janë vërtetë në kushte më të mjerueshme sesa këta persona të cilët mund të jenë 46 vjeçarë 50 vjeçarë të cilët janë të aftë për punë.

Pashke Marku, Përgjegjëse e ndihmës ekonomike: Ato që ndihma ekonomike që thotë nuk janë të punës nuk shkojnë me mendimin që mund të ofrohet puna, por ato që puna u ofrohet refuzon dhe tërhiqet nga sistemi refuzim punës e ato që janë sot në sistem.

Aida Skeja, këshilltare: Okej, faleminderit për përgjigjen, do ju lutesha që të kishte dhe një bashkëpunim lidhur me persona të cilët unë personalisht i shoh që janë pjesë e ndihmës ekonomike këtu por që... mendoj që një 46 vjeçar mund pra me aftësi për punë mund të gjejë një punë dhe është ju ofrohet nga zyra e punës një punësim dhe rehat rehat thotë mos të shkoj në punë po të marr këtë ndihmën ekonomike ku fare mirë mund ta marri dikush që është më tepër nevojë, faleminderit, atëherë hedhim votim.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Kush është pro? Kundër, miratohet,

Vendimi 2: Projekt vendim për miratimin vazhdim të procedurave të heqjes nga fondi pyjor kullësor e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes për zhvillimin e aktiviteteve minerar nga shoqëria Kotica shpk

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: kalojmë në pikën dy, projekt, projekt vendim për miratimin vazhdimin të procedurave të heqjes nga fondi pyjor kullësor e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes për zhvillimin e aktiviteteve minerar nga shoqëria Kotica shpk. Tani kush do flase, përgjegjësi, drejtori?

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Kemi dy relacione dhe projekt vendime, dhe projekt vendime për dy subjekte, Kotica, shbk dhe Cara SPK, për Koticën. Për Koticën SHPK. Unë kërkoj mirëkuptimin e të gjithë anëtarëve të këshillit, sepse pas dhënies së lejeve përkatëse nga dy institucionet, ministria e minierave dhe ministria e mjedisit, ju thjesht është detyrim ligjor që të kalohet si projekt vendim, sepse thjesht po bëni pengesë për mbledhjen e të ardhurave, për ne është detyrim ligjor, për bashkinë që këta ka për ty me e sjellë këtu, dëgjo, kjo është pjesë detyrimi edhe krijo debat me kësaj.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Albert ta dëgjojmë deri në fund, pastaj merr fjalën, diskuto sa të duash.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Sepse unë kam bërë dy takime paraprake edhe me Arbër Lekën edhe me përfaqësues të tjerë ku ju kam... në dispozicion dy lejet përkatëse, ju mund t'i keni dhe parë një pjesë, janë dy lejet përkatëse dy ministria e vetëlinjës që janë dhënë për të dy subjektet me sipërfaqe dhe koordinata. Dëgjo, nuk unë kur them, kur them se është detyrim ligjor, kur them se është detyrim ligjor, ne nuk kemi pjesë si bashki.

Luigj Lepuri, keshilltar: kur na gjej ligjin që thotë duhet me e votuar pro këtë ose kundra ose detyrim ligjor

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: është detyrim ligjor mos mos më keqkuptobert detyrimi ligjor është për firmën që të vazhdojë procedurën dhe të punojë atje ju si kaluar pro Luigj si e kaluat pro si kaluat kundra ju nuk e pengoni as me firmën do të ushtroj aktivitetin sepse ka marrë lejen nga dy ministritë përkatëse.

Luigj Lepuri, keshilltar: Ore këshilli ndoshta ka për ta votuar 100% prapa ti mos. është detyrim ligjor me votu. Vendos a votum, votum kundra herën tjetër, pse e sollë prapë, unë s'pou detyroj ju që të votoni kundra.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Unë po them detyrimin ligjor.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Ju lutem. Ta dëgjojmë deri në fund, mos të kapemi mbas fjalëve, mas gjërave që s'është për tu kap, ta dëgjojmë relatimin, të shohim si janë punët, çfarë kërkohet nga ne, ju lutem, ju lutem. Deri në fund relatimin e drejtorit disko po.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: O kryetare o kryetare dakort edhe ne nuk jemi tashti o zonja kryetare juntut unë nuk u shpreha gabim unë thashë që ligjor detyrimi detyrimi detyrimi ligjor nuk ka detyrim nuk ka detyrim është me mirëkuptim ka mbaruar firmat gabim. Ka ezauruar drejtor detyrimi ligjor ishte me ecë o drejtor o drejtor nuk do ta bëjmë debat se firma është në rregull nga ana ligjore ju lutem po jo moreu detyroj se një detyrim është në rast se ju keni

detyrim për bashkinë që të hedhi dy taksa mos u bëni pengesë ju ftoj që ta miratori kaq drejtor. Ju lutem,

Albert Ndoci, Këshilltar: drejtor ti të duket detyrim ligjor sepse more një miratim në rravën tjetër që në muajin janar që krye detyra drejtor të duket detyrim ligjor ty sepse ne këtë propozimin që bëre rravën e kaluar në janar sikur kishe kryer detyrat dhe ne ta miratuam prandaj bëë kështu duhet të kishim që në mbledhjen të parë ndryshe ne që ti të ishe pak më ndryshe sot kështu që kujdes me deklaratat dhe me komunikimin që flet këtu me neve.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: A t'ia japim mundësinë ta çojë deri në fund, drejtor, ke gjë tjetër? Nënkyetar, po me radhë mor burri i dheut, me radhë.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Sipërfaqja, sipërfaqja është nënë pikë, për Koticën është 6.5 hektarë, firma përkatëse nuk ka zhvilluar aktivitetin, nuk ka filluar aktivitet paraprak, është përcaktuar vlera e lëndës brusore dhe sipërfaqes që do hiqet nga fondi pyjor. Por është një vlerë të përafërt të llogaritur në 1 milion e ca 700.000 all, ju keni të gjitha para dokumentacionet përkatëse që i përkasin firmës, nuk e di nëse në lidhje me raportin, keni ndonjë gjë, ndonjë pyetje, po kam unë pyetje. Unë po ju lexoj shkresat, ju keni të gjitha në kompjuter. Se doni të rilexoj shkresat dhe urdhrat, unë po lexoj, ju keni para, unë nuk kam çar t'i shtoj, ça keni gjë të paqartë, mund të më pyesni.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit Jo, në qoftë se është në zarf, nuk është nevojshme. Tashi o drejtor, me pak fjalë përmbledhe, ideja është, ai ka marrë lejen, subjekti ka marr lejen e shfrytëzimit, tashi ne si këshill çfarë bëjmë, kalojmë nga fundi bashkisë e kalojmë në fond privat pronë private si ë.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Po e kaloni me heqjen, miratoni heqjen nga fondi pyjor dhe kalimin në përdorim për 10 vjet. Toka është prapë truall, është tokë shtetërore pas 10 vjetësh, pra pra vlerësohet sipërfaqja e bimësisë pyjore aty ku do të ushtrohet aktiviteti dhe hiqet nga fondi pyjor, bëhet pagesa përkatëse sipas subjektit në të ardhura të bashkisë edhe për... 10 vjet ajo jepet në përdorim për.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Po 10 vjet në përdorim kundrejt një takse të ardhurave që vjel bashkia, pyetje, pyetje.

Altin Bruka, këshilltar: Kisha pyetje unë. Ë, faleminderit për kohën, ju me sa thatë drejtor, e kam parë dhe e kam lexuar komplet çfarë kompania ka për hoqit, unë kam një pyetje për ty: Ku është veriu dhe ku është jugu këtu te kjo harta që ka paraqitur kompania,

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Dëgjo, kjo është vetëm harta që tregon parcelën ku është futur. Subjekti dhe ku pretendohet, janë dhe katër harta të tjera topografike të shkallës 1:10000, dosja e çdo subjektit mund të ketë 100, 150 faqe. Unë nuk mund ta fotokopjoj gjithë dosjen po për sqarim po të them se janë dhe katër harta të tjera topografike me të dhëna kadastrale të rregullta që përcaktojnë të gjitha të dhënat edhe shenjat e hartë,

Altin Bruka, këshilltar: çdo hartë drejtor do ketë busull, po normal që pse s'ka busull kjo, ku është veriu, si ta mbaj kështu, kështu apo kështu,

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Ajo është është dhënë me të gjitha detajet, vetëm për parcelën, të thashë dhe njëherë, ajo tregon vetëm kufitt e parcelës dhe e cilës parcelë përkasin koordinatat të cilat ai do të shfrytëzojë,

Altin Bruka, këshilltar: Super te koordinata kam një kështu. Ju si drejtor besoj që e një portalin.gov, nëse mundesh, tani mund të hysh edhe në telefon, në telefonin tënd dhe mund të vendosësh kordinatat, ypsilonin dhe x-in, ku rezulton te këto koordinata kjo, ky location. E di ku të rezulton drejtor, në Somali, sepse ai që ka bërë këtë hartën ka ngatërrunin dhe x-in, kanë ngatërruar komplet kollonat nga exceli, kjo një, po kush të dojë tani ke tek gjeoportal.gov.al. të koordinatat ku del lokacioni, ideja mjedisore tjetër, prit ta mbaroj tjetër, kam diçka tjetër, këtu ke 47, 71, 33 pike 6, mbas pikës duhet të ketë tre shifra, sepse pikë gjashtë e ke këtu, nëse unë ta bëj pikë 69, zgjerohet terreni, koordinatat janë po kordinatën e ke pikjashtë, duhet të ishin duhet të ishin tre shifra pas pikës,

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: jo koordinatat janë të përcaktuar nga ministria e linjës, sepse këtu te leja minerale, ja ku ke. "Ja ku ke kordinatat me sipërfaqet që do të shfrytëzojë dhe busën për drejtimin dhe të dhënat katastrale e përcakton ministria ju keni kapur

Altin Bruka, këshilltar: Si t'japim ku e vendos kufirin ti urdhëro ku e vendos kufirin mbas pikë gjashtës rrethin në vetëm bëjmë konfirmimin në terren të koordinatave zoti po për terrenin po flas pra këtu ke pikë gjashtë do të ishte me tre shifra unë nëse unë mbas gjashtës vendos 99 i bie që unë të zgjerohem në terren të marr terren më shumë"

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Ore ti flet për numrat e koordinatave ë koordinatat janë fikse janë me numra fikse more kush është me numër fiks koordinatat të lutem lexoje udhëzimet siç duhet mbas pikës duhet të jenë me tre duhet të jenë me tre shifra dhe ka dy katër tetë nëntë nëntë numra drejtor mbas pikës do të jetë me tre shifra.

Eduart Kurti, nënkryetar I bashkisë: I nderuar këshilltarë, do kërkoj mirëkuptim pasi këtu jemi në një nivel pak shumë të lartë drejtuesish dhe njerëzish të cilët janë marrë me këtë punë shumë serioze edhe për tu kap me me ca me lojra fjalësh dhe me ca detaje që këto janë miratuar ministri dhe ka ardhur firme ministri dhe kanë ardhur këtu te ne, i kemi studiu, janë dosjet voluminoze, në qoftë se keni dyshime mund të vini te zyra, t'i shikoni dhe hartat e tjera

që ju referoj drejtori, por unë mendoj që mos na mendoj. Mos ta humbim kohën, mos ta humbim kohën me këto me këto, as detaje nuk janë, por janë lora fjalësh të cilat mund të kapim deri nesër, pse ke kreh flokve djathtas, pse ke kreh të majtas, këtu janë hartat dhe nuk luajnë, janë harta të marra nga hartat ekzistuese, janë pak të vjetra dhe janë ca ypsilon i që ne janë inxhinier ato që merr, në qoftë se keni pyetje konkrete që të bëhen.

Altin Bruka, këshilltar: I nderuar nënkryetar nuk është... lojë flokësh as majtas as djathtas, është një pyetje nga ana ime, ju si bashki kur keni marrë në dorë, nuk është se kupton pyetjen, kjo është një pyetje, pse ka ndryshim y me x-in, futi tani ti dhe del diku tjetër o ti, pse e keni ba gabim, dëgjo mu.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Altin, kjo është miratuar kordinatat janë miratuar me lejen minerale të ministrisë përkatëse, atëherë ministria ka miratuar kordinatë. A të flas unë ta mbaroj atë se unë po të dëgjoj të lutem edhe për kulturë se ne jemi tashi duhet ta marrim vesh ndori-tjetrin po pra këto koordinata që ka miratuar në leje ministria e përkatëse ne bëjmë verifikimet në terren dhe koordinatat kanë koordinuar me verifikimet dhe pikat në terren, kaq kam detyrim unë, në qoftë se ministria dhe sekretari i përgjithshëm i ministrisë për të cilin është kompetent për dhënien e lejeve ka hedhur gabim mua mos më pyeti për...

Altin Bruka, këshilltar: Je në rregull me këtë shifrën 47 71 33.6 urdhëro je në rregull me këtë koordinatë

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: me koordinatat që ka punë ministria dhe në rregull jam në rregull po jo s'ja në rregull fare në qoftë se ti s'je në rregull hajde unë të vej dosje në dispozicion dhe faleminderit

Altin Bruka, këshilltar: Unë të ftoj drejtor në kohën tënde të lirë te kjo portali fut koordinatat y dhe x-in dhe ku del ky lokacion në kohën tliërë dhe të gjithë juve këto koordinatat që keni 47 71 33.6 dhe 46 02 54 07.7 futini tek gjeoport.al dhe ku ju del ky kjo vendndodhje.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Ju lutem, ju lutem, po ded.

Ded Ndreca, këshilltar: Përsa i përket koordinata që thotë ai, ai ka të drejta këshilltar me bërë pyetje çdo këshilltar, por ato nuk guxon njeriu me lujt se atë miraton ministria, janë të piketuar dhe nuk guxon me hy as me lujt as me shtuar më nesër pasnesër.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Jo unë mendoj se do jetë një gabim teknik.

Altin Bruka, këshilltar: Absolutisht është gabim teknik dhe është gabim tek exceli. Është gabim. E kuptoj unë, po duhet të ishte kapur nga ata.

Ded Ndreca, këshilltar: Edhe unë këtë mendoj, që është gabim shpejtësie, një presje, një numër një edhe del në Somali, se normale s'është nga Shqipëria.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Unë kam se si e quaj gabim Altin atë koordinatë për sa kohë unë e kam verifikuar në terren me raportin që kam bërë dhe më kam koordinuar pika fikse.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: drejtor o drejtor drejtor është më korrekte me thënë që bëm një gabim njerëzor dhe e shohim sesa t'i mëshojmë asaj që ministria gabim, ne gabim, ata gabim, ai gabim ajo koordinatë që thotë Altini do të verifikohet. Nuk është kjo çështja kryesore, nuk është kjo çështja për të cilën po diskutojmë, kush diskutim tjetër, pyetje tjetër, po.

Ded Ndreca, këshilltar: Thamë dy llafe pra, se nuk ju ndërpres ndonjëherë. Për sa i përket firmës Kotica. Është një biznesmen shumë mirë, unë të jem i sigurtë e kam shumë mik, ka 35 vjet, 34 vjet që paguar taksat e bashkisë, kanë ardhur njerëz nga Kavaja, nga Shijaku, nga Durrësi, nga Japonia, kanë marrë këtu në zonën tonë. Pse mos e marrë ai që është venali edhe taksapagues i kësaj bashkie unë kam mendimin që bashkë me kolegët e mi të këshillit ka qenë dhe sponsor te ekipi i Mamurshit prej katër vitesh ka sponsorizuar edhe për bashkinë po të është nevoja ndihmon gjithmonë kështu që kam mendimin që ta ndihmojmë ta flasim.

Altin Bruka, këshilltar: Mundem pak po ë i nderuar ded unë nuk kam me gjë Koticën unë e het si problematikë kam shumë respekt në distancë absolut. problematikë që do të ishim kapur nga ata, nuk e kam drejtpërdrejt as nuk e jap as dit që kush është. Jam pro sepse kanë, domethënë do punësohen, do shtrohen rrugë, janë pluse, unë thjesht janë gabime që këto duhet firmë thotë, duhet të liçencu, ai s'ka liçencu ai që ka bënë hartën e pranon, ndërsa për portalin duhen liçencë, e kuptot dot se çfarë bëjmë.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Për t'i heq merakun profesorit mbas mbledhjes do ta ta ftojme të drejtorja ta verifikojmë, ta bëjmë verifikim.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Patjetër nënkrytar, nuk është kjo gjëja kryesore.

Sabahete Hidri, këshilltare: Përshëndetje të gjithëve, tani një sugjerim dashamirës më shumë, për të gjithë drejtorët e Bashkisë Kurbin, gjithë ai investim që është bërë, ju lutem rritni performancën në komunikim me anëtarët e këshillit të bashkisë, ju lutem kontrolloni materialet është bërë disa herë, nuk pse duhet të harxhojmë kohën, se është një datë ndryshe, është një shifër ndryshe është një kur ju keni shumë specialistë dhe ku shumica e drejtorëve të bashkisë kanë qenë vetë drejtues institucionesh, më duket papranueshme që të vazhdojmë mbledhje pas mbledhje. Kurse për mbështetjen e bizneseve unë jam dakord sepse krijojnë vende pune, hapen më shumë mundësi për të ardhura për bashkinë. Përderisa është dhënë leja dhe lart, për të dyja subjektet jam dakort që okej. Kurse performanca asnjë drejtor në Bashkinë e Kurbimit dhe kudo nuk mund t'i drejtohet anëtarëve e këshillit që ju keni detyrim ligjor ishte një keqkuptim po duhet të zoti nënkryetar jo për Tanin zoti nënkryetar jo për Tanin se Tani ka drejtues por në qenë vetë përgjithësi ju lutem jeni më të vëmendshëm dhe keni më shumë kujdes dhe respekt për anëtarët e këshillit kaq faleminderit!

Albert Ndoci, këshilltar: Mirëdita të gjithëve, tashi unë më shumë, edhe pyetje po edhe një farë sqarimi duhet ta bëjmë me këtë, përse i përketë të parë për... raportin teknik që është raporti teknik duhet të jetë i shoqëruar me dakortësinë e fshatarëve se do s'do shteti u ka marrë njëherë nga 50 vjet që ja ka marrë tokën, ajo tokë dikujt është pavarësisht se thotë jashtë e shtetit, kështu kam pas unë eksperiencën time e shtetit ishin po pra kështu që unë gjithë

respektin unë në radhë të parë kërkoj që të ketë për këto të dy subjekti të ketë raport për dakortesine me qytetarët që mund të jete po unë nuk e kam lexuar.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Unë desha o berdi leja mjedisore që ka dhënë nga ministria e turizmit ka dhe klauzolën për dakordësinë me komunitetin dhe ajo në databasein e vetsajtin. Shpall datën e dëgjesës publike para se të miratojë lejen, domethënë është bërë ajo dhe në rast se dhe në rast se në faqe të detabajsit të ëbsajtit të vet nuk ka kërkesë nga komuniteti për kundërshtim të këtij, ato kalojnë në heshtje dhe është miratuar në heshtje, e ka ligji, unë i kam ligjet këtu të cituma tek projekt vendimi që ju po t'i hapni e sheh,

Albert Ndoci, këshilltar: Ne kena pas eksperiencën në Malbardhe, ti e di shumë mirë që edhe këshilli ato edhe njerëzit. Unë me ty jam dakort në rast se për mua si subjekt për rastin konkret kemi një petition ose një kundërshtim nga banorët me fakt konkret jam dakord me ty po për sa kohë nuk kemi ne si drejtori si bashki ne s'kemi pse të paragjykojmë jo jo nuk ka parashikim po duhet të pyetes se ti je desh ma marrim diçka objekt duhet ta pyesish atë ti se pyet fare

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: me kontaktet me me banorët i kemi marrë dhe s'kam pas nonjë kontakt sepse ne kemi pas edhe ato hedhjen kullotave për qira dhe banorët që janë aty kanë e përdorin territorin për kullotë dhe s'kanë pasur asnjë lloj pretendimi ose kundërshtim. s'kemi pas ndonjë raport ose ndonjë petition kundra prandaj po të them po tjetër edhe tjeta i parkush zeti për komunitetin.

Albert Ndoci, këshilltar: Edhe edhe një një sqarim të vogël tashi duhet të bë një Kurbini dy rrugë ka malore, Gallatën tre, Selitën edhe Shemrinë, të paktën edhe bashkë, se dhe bashkia ka mirëmatjen, po të pakte të jete klauzola, për dy makina qakull me hedh në këto dy tre rrugë, dy makina, mire janë.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Faleminderit! Sefedin.

Sefedin Lika, këshilltar: Po atëherë sa i përket dy gurorave unë jam kundra për arsye se jam personi nga Mali i Bardhë që e ceku kolegu që e kena vuajtur. Atë kohë, pavarësisht se, siç thotë drejtori, janë vendos nga lart, se andej i rregullojnë punët, po kur të vijë puna në fshat marrin 10, 15 firma edhe komplet katundi kundra, kjo duhet rishikuar e duhet sqaruar mirë, se mësojmë si Malbardh sin ë Borizane pasojat janë të ndryshme, kështu që nuk kemi. Nuk kemi asnjë problem me këto firmat, fatmirësisht i kemi të zonës tonë, se ajo firma herës tjetër ishte me iniciale, se kena kuptuar fare, veç e kena votuar kundra, kështu që dikush ndoshta ka interes se ka kushri, dikush mik, këtu nuk kemi ardhur me votu as për mik, as për kushrij, por me zbatu ligjin edhe mos me e cënuar. Tani t'i ngrem dorët ose të shkojmë krijojmë një komision, të shkojmë të verifikojmë vendin, pastaj ta miratojmë se nuk kena gjë me biznesmenët tanë.

Eduart kurti, nënkryetar I Bashkisë: Të nderuar këshilltarë, mund të bëjë sqarim, siç e shpjegoi edhe drejtori, një pëlqim dhe një dakordësim me qytetarët, po patet njoftimi nga ana e ministries si detyrim ligjorë përpara se të mari vlerësim, ndikimi në mjedis do merret konsulta me qytetarët, pavarësisht se... nuk është shtet edhe për vetëm për ndikimin mjedis merret, njoftimi është bere dhe jan qytetarët qe flasin, Ka një relacion që merret nga ministria, kur vjen te ne. E plotësuar pra kur jepet besimit është miratuar faza. Ne këto rast nuk është detyra jonë për ta bërë, nuk është detyrimi jonë, detyrimi ligjor për ta hequr nga fondi pyjor dhe për ta

përdorë për të gjeneruar të ardhura. Domethënë kaq me pëlqimin me dhëne pëlqimin tuaj e heqim nga fondi pyjor dhe kalojmë për shfrytëzim ja kalojmë problemit, kjo është hallka jonë.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Po e kaluam atë pjesë. Faleminderit. Po, zoti Pashk.

Pashk Prenga, keshilltar: Tani përshëndetje të gjithëve. Më vjen shumë mirë që në Kurbin dy subjekte aplikojnë për një tjetërsim: një prioritet kullësor në aktivitet privat. Kjo vetëm zhvillim ka, vetëm anë pozitive, por përveç anëve pozitive ka edhe ndonjë efekt negativ që ndoshta, ishalla, do Zoti kur te bëhet transparenca atëherë për të mirën e subjekteve në radhë të parë, dy subjekteve që kanë aplikuar që të mos ketë, mos ndëshkohen nga njerëzit që banojnë atje duke filluar nga rruga kryesore asfalt deri në pikën e fundit, të mos penalizohen nga banorët e mos ju shkojë munda dam. Tani lidhur me grupin e punës. Dihet, subjektet kanë aplikuar te e-Albania, është miratuar nga ministria, ministria ka dalë me një projekt, me një vendim, është dhënë një leje. Do të ishte mirë kjo leja me qenë këtu te materiali. Leja? A duhet të ishte mirë me qenë këtu për të dy subjektet? Do të ishte këtu o vëlla, material këtu normalisht o shoku, leja që është miratuar nga dikasteri nga ministria përkatëse a duhet të ishte këtu. Pyetja do të ishte mirë me qenë këtu për transparencë.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Nuk është detyrim, nuk e kemi detyrim për transparencë. Bëhet fjalë, ne e sjellim në rast se ju e kërkon, por në relacion po t'i vësh re e ke të cituar me të gjitha numrat po ta hapësh ke faqja.

Pashk Prenga, keshilltar: Tani do të ishte mirë fizikisht leja për një flete format që është leja, mos të ishte depozituar këtu. A do të ishte mirë të ishte sa për informacion, një informacion më tepër është ajo e dyta. Tani ky projekt, ky licenca, ky projekti nga ministria ka ardhur te bashkia, ka ardhur te këshilli bashkisë, dhe njësia e qeverisjes vendore që janë ato e diskutuar sot del me një vendim. Në qoftë se nuk miratohet nga ana jonë, si veprohet? Nuk u miratua nga ana jonë, si veprohet?

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Në qoftë se nuk miratohet nga ana juaj, bashkia thjesht nuk mbledhë ratifikimin e këtij subjekti dhe ju nuk bëni dot pengesë për ushtrimin të aktivitetit të atij subjekti. Nuk bëhesh dot pengesë sepse ka lejen.

Pashk Prenga, keshilltar: Pse vini këtu atëherë për me miratuar ne është procedurë në vazhdim. Vazhdimi këtu thotë vazhdimi e procedurës për heqjen nga fondi pyjor, pra ka marrë lejet përkatëse dhe kërkon vetëm miratimin e procedurës për...

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Miratojmë i nderuar këshilltar. Atëherë, të lutem, mund të jap përgjigje. I nderuar këshilltar, zoti Pash Prenga, në respekt të ligjeve, çdo vendim dhe çdo kundërshtim që bëhet dhe nga ana e këshilltarëve dhe nga ana e administratës, është mirë që të bazohet në një bazë ligjore. Edhe në këtë rast, nga të paktën nga interesimi që kemi bërë me ministrinë, ti duhet të japësh një argument dhe një bazë ligjore kur kundërshton një projekt dhe një relacion. Pra minimalisht, është barra jote që ta kundërshtosh me një argument të qartë dhe me një bazë ligjore. Dhe këtë pyetje po ta bëj unë ty, me çfarë baze ligjore dhe me argumenti, pastaj me ushtruar të drejtën pro dhe kundër është, po duhet argumentuar sepse dhe ministria të në shfrytëzim të kompetencave që ke si këshilltar, ke dhe detyrime si këshilltar, jo vetëm ca të drejta, kështu që një arsye duhet ta japësh.

Pashk Prenga, keshilltar: Tani s'po i hyjmë kësaj sepse s'po bëjmë debate në qoftë se është. Jam plotësisht dakord me argumentimin që disa këshilltarë e bën unë fjalinë e parë. Fjalinë e parë e thashë, është shumë mirë që dy subjekte kanë aplikuar në Kurbin për këtë aktivitet. Kjo është shumë mirë për mua. Pjesa e dytë, po që puna me argumentuar me mënyrë të thellë, te probleme sociale e thashë edhe njëherë tjetër, që probleme sociale që mund të dalin për shkak të këtyre aktiviteteve të dy subjekteve, pastaj ndoshta do kthehet në bumerang edhe për subjektet edhe për popullsinë.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Po janë hapa, janë hapa ligjorë, ti e di shumë mirë. Me liqet dhe me janë hapa ligjorë që janë a-ja deri gzh-ja, edhe nuk kemi anashkaluar.

Pashk Prenga, keshilltar: Edhe te saktësia e vlerësimit të bimësisë pyjore, florës dhe faunës e përbën nga me presatore e çdo gjë. Bravo, e qoftë, keni bërë një mbajtje spektakulare. Vlera e lancës përpunim punimit 5.7 m³, vlera e druve të zjarrit 173.8 m³, vlera e prodhimeve të dyta pyjore 160. Del, nuk është normal, nuk është serioze, a kupton?

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Të lutem, drejtor, do ta hedhim në votim.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Sqaroj një moment, ky raporti teknik që kemi hartuar ne. ky shkon, ky shkon në ministri dhe miratohet, nëse e kemi bërë në rregull ose jo se përcakton vlerën e damit, ky shkon. Jemi të detyruar t'i bëjmë konçisë me çdo shifër për sa kohë ato shkojnë për verifikim në ministri dhe e dyta planet ish planet e menaxhimit i kanë standardet fikse të përcaktimit të lëndës drurhësore dhe janë ca koeficientë që unë si luaj dot.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Drejtor, faleminderit. Atëherë, para se ta hedhim në votim. Ju lutem, dëgjoni pak para se ta hedhim në votim mbështetur nenin 54 pika e ligji 139 ë votimi miratohet me 3/5 e votave të këshilltarëve, domethënë duhen 19 vota pro, kush është pro?

Aida Skeja, këshilltare: Kam dhe një pyetje, të lutem.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: A të lutem tani, ne po flisnim deri tani, bëje pyetjen te subjekti tjetër, tashi unë hedh në votim mojdë, po bëje, bëje, bëje, bëje. Hë, prit, prit, Arbër, se është tu fol,

Aida Skeja, këshilltare: E di pse kisha këtë pyetje, thjesht ndoshta është një lapsus ose, është për të dytën herë, që është vlerë, vlera e druve të zjarrit, kaq, nuk kam asgjë tjetër, thjesht 173.8 m³ me vlerën 600 all të vjetra, ose 600, 600 all të vjetra, më falni, 600 lek, domethënë. Të nderuar drejtor, unë vetëm këtë doja të dija, që vlera e drurëve për metër kub me 6.00 all të vjetra, unë në fakt 1 metër kub e kam blerë në dimër me 70.000 all minimumi, nga nxorre ti me 6000 all të vjetra, të lutem, Vetëm këtë përgjigje s'kam, faleminderit nëse ma sqaron.

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Mund të përgjigjem Dëgjo, çdo tarifë është bazuar në VKM numër 885 që keni aty, mund ta hapni dhe... shihni pikën konkrete për llojet e lëndës drurësore.

Aida Skeja, këshilltare: I nderuar drejtor, kjo tregon vlerën reale të tregut?

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: E ka VKM-ja. Me 6. Në qoftë se ka VKM-ja atëherë.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Do ta hedhim votim, do ta hedhim votim, ju lutem, i nderuar drejtor, ne jemi pro, jemi pro zhvillimit, Pro? Kundra? Miratohet! pro 27 , Kunder 1 absternim 0 ? Miratohet

Vendimi 3: Projekt vendim për miratimin vazhdim të procedurave të heqjes nga fondi pyjor kullësor e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes për zhvillimin e aktiviteteve minerar nga shoqëria Aghak Cara shpk

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: kalojmë te pika tjetër, që është e njëjta gjë, veç se është subjekti Agat Cara, do t'i fillojmë diskutimet, do ta hedh në votim, në votim, në votim. kush është tjetër kundër, Mos pyet pra, është një votë kundër, të gjitha të tjerat janë pro,

Altin Bruka, këshilltar: Faleminderit kryetar për për kohën, i nderuar drejtor, meqësim tek hartat për të treguar ndryshimin. Do bëj një koment mbi hartën tjetër Modeli i hartës duhet të mbajë këto të modeli i elemente, ku po t'i marr të dyja, Cara shpk thotë kufijt qar referencuar, më falni ka, kufiri i fondit pyjor kullosar ka, legjendat i ka, elementet natyrore i ka në hartë, zonat e mbrojtura ka bërë me shënime, shkalla e hartës drejtim veriut ka që t'i tregojë drejtorit se thotë është gabim, është këtej ë dhe përveç se legjendat ke edhe inxhinirat përkrahen në hartë, kjo është ndryshimi drejtor. Kjo këtu me këtë këtu, këto ishin pyetjet e mia që bëra për sikur i përmban kjo harta duhet të kishte përmbajt edhe.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Po shumë dakord hedhim votim kush është pro në lidhje me subjektin në lidhje me subjektin Aghak Cara. Pro? Kundër? Kush është kundër? Një kundër, miratohet. pro 27 , Kunder 1 absternim 0 ? Miratohet

Artan Miza, Pergjegjes i Pyjeve: Të dashur këshilltarë dëgjo u falenderoj. Njëherë për votimin, por për nga ana teknike, për çdo sugjerim dhe pyetje që keni pasur, unë jam hapur tu ve në dispozicion çdo dokumentacion, që ju të sqaroheni dhe të qartësoheni nga ana ligjore për shkeljet apo ato diskutimet dhe sugjerimet që ju mund të keni.

Vendimi 4: Projekt vendim për miratimin e një ndihme financiare nga fondi rezervë

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Faleminderit, projekt vendim për miratimin e një ndihme financiare nga fondi rezervë, kush është ta ka nevojë për diskutim, hedhim në votim, kundër, kush është pro? Kundër? Miratohet. pro 28 , Kunder 0 absternim 0 .

Vendimi 5: Projekt vendim për miratimin e një ndihme financiare për mbështetje financiare për strehim

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Projekt vendim për miratimin e një ndihme financiare për mbështetje financiare për strehim, ka nevojë për diskutim, hedhim votim, po.

Majlinda Cara, kryetare e Bashkise: Përshëndetje të gjithëve. Kërkoj ndjesë për shkak të angazhimeve, meqë jemi vetëm te projekt vendimi numër pesë kryetare për rindërtimin, besoj

që jeni në dijëni është familja Rama që prej tre mbledhjesh në këshill për shkak të banesës dhe unë besoj që nuk ka më nevojë për material shtesë këtu pasi e kemi diskutuar në tre mbledhje radhës të këshillit, duke qenë se është në proces gjyqësor për vërtetimin e pronësisë dhe ne si bashki dhe ju si këshilltar që nga mbledhja e radhës, është lënë që kësaj familje t'i ofrohet një bonus qeraje deri në përfundimin e procesit gjyqësor në apel për ta bërë përfitues te procesi rindërtimit, duke qenë se pallatet në Mamurras janë ndërtuar, por për shkak të pronësisë nuk është shpallë përfituese dhe besoj familjen Rama kemi tre mbledhje që e diskutojmë, nëse duhet dokument shtesë, nuk di çfarë dokumenti shtesë tu sjellim. Do të japin bonus qiraje deri në momentin e përfundimit të gjyqit që del përfitues apo nuk del përfitues, Edhe nëse më mirë kuptoni, është edhe një familje, në fakt e kemi pas dje në takim dhe nuk arritëm të bëjmë projekt, është N.Gj. në pallatin 97, ku nga tërmeti vetëm kati i pestë është dhënë paabanueshëm. Në fakt duam ta trajtojmë edhe këtë me një bonus qeraje deri në përfundim të ekspertizave të thelluara të gjithë pallatit dhe bashkë me Ramën kërkojmë këto dy familje që të i miratoni për t'i dhënë bonus qira. Deri në momentin e zgjidhjes së problemit, janë të procesit të rindërtimit.

Pashk Prenga, këshilltar: Kryetar, nuk nuk thashë se nuk jam dakord me këta, por e sugjerova me e pas parasysh administrata qe te mos të vije me dy letra, nuk ka çfarë problemi ka me vendos një me vendosje, një karte identiteti, një kërkesë e qytetarit,

Majlinda Cara, kryetare e Bashkisë: nuk ai ka dosjen e plotë të rindërtimi dhe e kemi diskutuar edhe me dosje të plotë. Kemi diskutuar edhe në mbledhjet e më përpara, ka dosjen e plotë të rindërtimi dhe nëse duhet për të vënë dosjen edhe për punë minutash. Po familja Rama, kemi tre mbledhje këshilli që e diskutojmë për shkak të pronësisë që është në gjykatën e apelit dhe kemi kërkuar edhe nga këshilli që shpresoj sot sekretari i këshillit të ketë marrë që dhe këshilli Bashkiak Kurbin. T'i drejtohet ashtu siç është drejtuar administrata, kryetari i Bashkisë, Gjykatës apelit, për një përshpejtim procedure për shkak strehimit, sepse zonja është në moshë madhore dhe për shkak të strehimit duhet që të dali procesi gjyqësor, të dali shorti dhe për të dhënë, për ta diskutuar dhe për të dhënë vendimin, pastaj nëse gjykata vendos pro familjes apo kundër familjes, ne zbatojmë vendimin e gjykatës. Po familja Rama ka tre mbledhje radhazi që ju të dashur këshilltarë keni keni miratuar e propozuar në disa mbledhje radhazi se si duhet të veprojmë. Madje kemi qenë për t'i dhënë pronën, por ligji nuk lejon për sa kohë është në proces gjyqësor. Nëse ka ndonjë gjë shtesë për të sqaruar, me thoni.

Aida skeja, keshilltare: Diçka atëherë lidhur edhe me dhënien e ndihmës financiare. Te A.K., ndoshta për sugjerim dhe kjo, ca foto të bashkangjitur nuk do të bënin keq edhe për të na njohur edhe ne me gjendjen e personit në fjalë, sepse si A.K. kam nja 15, po t'i rendis unë, që janë vërtetë ndoshta dhe në kushte më të mjerueshme me familjet, me persona të cilët janë nëpër spitale e pa shtëpi pa asnjë gjë tjetër, një relacion me kërkesë të zonjës në fjalë. Me shkrim dorë, një firmë dhe një kartë identiteti i saj, ka vetëm një çertifikatë personale familjare, ndërsa të tjerat të paktën edhe dy foto mirë do të ishte, sepse mos i merrni, ju lutem, unë kam shumë konsideratë për secilin prej jush edhe për punën, mos i merrni si personale, e kam cilësuar disa herë, janë në shenjë të bashkëpunimit mes nesh dhe jush, për të qenë ndoshta dhe ne tepër komodë kur e ngrejmë një karton për të dhënë një ndihmë financiare, jo, jo vetëm

për këtë, por për qindra e mijëra që janë kështu në gjendje të tillë. Unë kaq kisha, nuk e kam asgjë personale, jua kam thënë dhe herë të tjera, faleminderit, faleminderit.

Marjana Gjini, keshilltare: Atëherë, përshëndetje, unë u bëhe disa herë që kam dhënë një emër, është një zonjë, është në moshë, është pa shtëpi, ia paguajnë qerata disa persona, më shumë për bamirësi dhe... nuk është dhënë ndihma sepse thonë nuk kemi ndihmë për momentin, meqë po kalojnë këto emra ta kalojmë dhe emrin e kësaj, të gjithë besoj se e njohin, P.D. ka emrin, është një zonjë e vetmuar, nuk ka as njeri, ti bëhet verifikimi, dakord.

Majlinda Cara, kryetare e Bashkisë: Të nderuar këshilltarë, meqë ju shprehni edhe kërkesën edhe për një emër tjetër, mund të miratohet nga këshilli dhe në parim, mund t'i bëhet verifikimi nga shërbimi social në banesë, sepse... rastit të A.K. mbas kërkesës edhe të një sëmundje të rëndë që zonja i është bërë verifikimi në banesë, shërbimi social disponon gjithë dosjen e plotë të saj dhe është e verifikueshme dhe e kontrollueshme, pa shërbimin social ne nuk kalojmë asnjë ndihmë financiare, nëse ju përkoni ta miratoni, është e drejta juaj, miratojmë në parim e miratoni në parim. I bëhet verifikimi në banesë nga gjithë shërbimi social i emrit të dytë, jo Afërditës edhe patjetër ne nuk jemi kundra për të dhënë ndihmë financiare çdo lloj banori të komunitetit tonë, jemi të hapur bashkë me ju besoj, për të dhënë, por duhet ditur që edhe buxheti i Bashkisë Kurbin, fondi rezervë që është për këto familje, nuk është dhe aq madh sa për të përballuar të gjithë komunitetin apo për t'i dhënë ndihmë financiare të gjithë komunitetit në Kurbin, por raste të veçanta, sidomos në raste sëmundjesh apo strehimi, apo ë, mos mungesa e punës e të tjerë verifikohen nga ne dhe patjetër i paraqesim këshillit për për miratim, kështu që çdo rast që vjen në këshill, të jeni të bindur, është i verifikuar nga gjithë struktura jonë, sepse kemi detyrim ligjor ta verifikojmë dhe nuk vjen asnjë rast këtu që duam ne t'i japim një ndihmë financiare apo duam ne t'i kalojmë një ndihmë financiare, rastet janë të verifikuara në banesë, por edhe me gjithë dokumentacionin të marrë me... të gjithë institucionet se nëse gëzojnë dokumenta të tjera që gëzojnë prona apo kanë mundësi punësimi apo të tjera patjetër këshillit nuk i vijmë për të kërkuar miratimin e këtyre familjeve.

Edlira Lleshi, Kryetare e Keshillit: Atëherë hedhim votim do ta hedhim për të tre emrat, të lutem i thoni emrin. Kush është pro 28, Kunder 0 absternim 0? Miratohet.

Të ndryshme

Edlira Lleshi, Kryetare e Keshillit: I japim fjalën, zj, gezime Veseli, kryetare e komisionit të barazisë gjinore për të raportuar mbi barometrin e barazisë gjinore në bashkinë Kurbin.

Gezime Veseli, keshilltare: Sic edhe u njohet me materialin që e keni në tavoline, po ju lexoj shkurtimisht pjesën kryesore të relacionit që ne si komision kemi hartuar në lidhje me barometrin i cili është edhe në nivel krahasues kombëtar me të gjitha bashkitë. Komisioni i Barazisë Gjinore paraqet sot përpara jush gjetjet kryesore të Barometrit të Barazisë Gjinore për Bashkinë Kurbin. Ky barometër shërben si një mjet thelbësor për të vlerësuar dhe monitoruar progresin e bashkisë sonë në adresimin e çështjeve të barazisë gjinore në nivele të ndryshme, nga përfaqësimi në administratë deri të shërbimet publike dhe alokimi i burimeve financiare.

Analiza e këtyre të dhënave na ndihmon të identifikojmë fushat ku kemi arritur progres dhe ato ku ende kemi nevojë për përmirësim dhe ndërhyrje.

Në vijim, paraqesim dy nisma konkrete të propozuara nga Komisioni i Barazisë Gjinore, të cilat besojmë se do të sjellin një ndikim të rëndësishëm në avancimin e barazisë gjinore në Bashkinë Kurbin: Nisma 1: Buxhetimi me Tregues Gjinorë dhe Zhvillimi i Programeve Gjinore. Aktualisht, Barometri i Barazisë Gjinore ka treguar se nuk ka programe ekzistuese që përmbajnë objektiva të qarta për barazinë gjinore, dhe mungon një sistem treguesish për matjen e performancës së shërbimeve publike nga këndvështrimi gjinor. Propozojmë që në buxhetin e radhes të merren masa për miratimin dhe zbatimin e buxhetimit me tregues gjinorë.

Dhe nisma 2: Emërimi i Nëpunësit të Barazisë Gjinore në Bashki, pasi Barometri ka nxjerrë në pah mungesën e një nëpunësi të dedikuar për barazinë gjinore brenda strukturës së administratës së bashkisë. Ky boshllëk e bën të vështirë koordinimin dhe zbatimin efektiv të politikave dhe nismave gjinore. Prandaj propozojmë: Krijimin dhe plotësimin urgjent të pozicionit të nëpunësit të barazisë gjinore brenda strukturës së administratës bashkiake. Ky nëpunës do të ketë një rol kyç si pikë kontakti dhe koordinator për të gjitha çështjet që lidhen me barazinë gjinore.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: I lutem administratës të mbaje shenim. Kalojme te pika tjetër. Atëhere na i sillni me shkrim ju lutem .

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur Laç **30.06.2025**.

Sekretari i Këshillit

Arber LEKA